**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER SOKOL SH. MALAJ**
**ADRESA NR.2, LUIGJ GURAKUQI**
**TEL: 684055554**

# VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

**Nr. repertori: 21**

**Tirane më 07/01/2022**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

V20220507100013500063

**AKTI I THEMELIMIT**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**AIEx Tech/Solution shpk**

Sot më datë 07.01.2022(dy mijë e njëzet e dy), përpara meje Noterit te Dhomës se Notereve Tirane u paraqiten personalisht:

- **"Austrian Institute of Excellence"** Shpk me numer NIPT :K31610206F, me seli Rruga e Dibres, perballe Viles Gold, Kompleksi Halili, Godina C, Kati 9, shoqëri e cila në bazë të Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të datës 05.01.2022, vërtetuar me Vërtetim Nëshkrimi me Nr 19REP datë 07.01.2022, i hartuar/noterizuar nga Noter Sokol Sh. MALAJ, perfaqesohet nga Administratorja **Znj. BIANCA FATBARDHA DI DURO –SPERNBAUER** e bija e Bido dhe Ramnije lindur në Tiranë më 30.06.1963 banuese në Tiranë Rr "Dibrës", e paisur me Pasaportën Austriake U 3146229, aktualisht përdoruese e telefonit Nr 00355684026340.—
- **Z. JUL SARAÇI**, i biri i Ardian dhe Florinda lindur në Tiranë 14.09.1990, me adrese banimi Rr.Bardhok Biba ,Nr.14,Tirane, i identifikuar me Kartën e identitetit me numer personal J00914055U.—

Të cilët janë madhore e me zotësi juridike për te vepruar, për identitetin e te cilëve u sigurova nga dokumentet qe me paraqiten. Personat e mësipërm, me vullnetin e tyre te plote dhe te lire hartojne këtë Akt Themelimi të shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar sipas dispozitave te mëposhtme.

## 1. Emri dhe selia e Shoqërisë

A. Emri i Shoqërisë është: AIEx Tech/Solution shpk

B. Emri tregtar i Shoqërisë është: AIEx Tech/Solution shpk

C. Selia e Shoqërisë është: Shqipëri, Tiranë, Rruga „Dibrës", Kompleksi Halili, Godina C1, Kati 8.

## 2. Fillimi dhe kohëzgjatja e Shoqërisë

A. Shoqëria fillon aktivitetin e saj me regjistrimin ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.

B. Kohëzgjatja e kësaj Shoqërie është e palimituar.

## 3. Objekti i shoqërisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Sherbime ne fushen e teknologjise se informacionit dhe komunikimit (TIK).
2. Konsulence dhe menaxhim te projekteve.
3. Dizenjim, implementim dhe mirembajtje te sistemeve.

4. Projektim, zhvillim, implementim, testim dhe mirembajtje te platformave dhe sistemeve software e hardware qe perfshihen ne aktivitete ICT, ne te gjitha fushat e aktivitetit te edukimit
5. Aktivitete ne fushen e edukim TIK it dhe te zgjidhjeve interaktive multimediale,
6. Dizenjimi grafik, zhvillim dhe mirembajtje e faqeve web.

## 4. Kapitali themeltar dhe aksionet

A. Kapitali themeltar është në shumën 100.000,00 (njëqind mijë) lekë.

B. Kapitali themeltar përbëhet nga dy investimet fillestaret / kapital i investuar të Shoqërisë:

- Ortaku themelues Austrian Institute of Excellence Shpk: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 67,000 që përben 67% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku themelues JUL SARAÇI : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 33,000 që përben 33% të kapitalit themeltar të shoqërisëOrtakët marrin përsipër kuota sipas investimit të bërë në shoqëri.

C. Ortakët janë të detyruar që pas firmosjes së aktit te themelimit të paguajnë në një llogari pranë një institucioni financiar brenda tre ditëve shlyerjen e plote te kontributit te tyre ne shoqeri.

## 5. Administrimi

A. Organet statutore të shoqërisë janë një ose më shumë administratorë, të cilët zgjidhen nga asambleja e përgjithshme. Administratori vendos në emër të shoqërisë.

B. Administratore e shoqërisë është:

1. Bianca Fatbardha Di Duro - Spernbauer
   me seli në Republikën e Shqipërisë / me numër pasaporte U 3146229,
   adresa: Tiranë, Rruga: „Dibres" Pallati përballë Vilës Gold, Godina C1, Kati9.

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

C. 1. të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

2.të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
3. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
4. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
5. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

D. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

E. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave A dhe B të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

F. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

1. u kthen ortakëve kontributet;
2. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
3. u shpërndan aktivet shoqërisë;
4. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
5. jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## 6. Juridiksioni

A. Te gjitha mosmarreveshjet qe lindin ne lidhje me kete akt themelimi midis paleve ose lidhur me shkelje apo pavlefshmeri te tij do te gjykohen perpara gjykates kompetente ne Tirane. Çeshtje te diskutueshme do te zgjidhen nga perdorimi i ligjit shqiptar.

***ORTAKET***

***E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

***"AIEx Tech/Solution Shpk "***

**"Austrian Institute of Excellence"** Shpk
perfaqesuar nga Administratorja

**Znj. BIANCA FATBARDHA DI DURO –SPERNBAUER**

**Z. JUL SARAÇI**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER SOKOL SH. MALAJ**

V20220507100013500063

**DATE 07/01/2022**
**NR REP 21**

## VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 07 Janar 2022 (dy mije e njëzet e dy), ditën e premte, para meje Noter SOKOL SH. MALAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANE, NR.2, LUIGJ GURAKUQI, u paraqitën personalisht:

**P A L Ë T:**

**"Austrian Institute of Excellence" Shpk** me numer NIPT.K31610206F, me seli Rruga e Dibres, perballe Viles Gold, Kompleksi Halili, Godina C, Kati 9, shoqëri e cila në bazë të Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të datës 05.01.2022, vërtetuar me Vërtetim Nëshkrimi me Nr 19REP datë 07.01.2022, i hartuar/noterizuar nga Noter Sokol Sh. MALAJ, perfaqesohet nga Administratorja **Znj. BIANCA FATBARDHA DI DURO –SPERNBAUER** e bija e Bido dhe Ramnije lindur në Tiranë më 30.06.1963 banuese në Tiranë Rr "Dibrës", e paisur me Pasaportën Austriake U 3146229, aktualisht përdoruese e telefonit Nr 00355684026340.—

- **Z. JUL SARAÇI,** i biri i Ardian dhe Florinda lindur në Tiranë 14.09.1990, me adrese banimi Rr.Bardhok Biba ,Nr.14,Tirane, i identifikuar me Kartën e identitetit me numer personal J00914055U.—

Deklaruesit e mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, dokumentin bashkëlidhur e hartuar dhe nënshkruar prej palëve në prezencën time, -sot më datë 07.01.2022.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018"Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

**SOKOL SH. MALAJ**

NOTER. SOKOL SH. MALAJ
RR"LUIGJ GURAKUQI" P 2 TIRANË. ALBANIA
Tel: +355 4 222 98 32 / Cel: +355 68 40 5555 4
e-mail: kolimalaj@hotmail.de

TAKSA E PULLES U PAGUA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER SOKOL SH. MALAJ**
**ADRESA NR.2, LUIGJ GURAKUQI**
**TEL: 684055554**

# VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

**Nr. repertori: 19**

**Tirane më 07/01/2022**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

V2022050710001272110

Austrian Institute of Excellence

Nr. 4715 Prot

VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Sot me daten 05.01.2022, u mblodh Asambleja e Zakonshme e Ortakeve te shoqerise Austrian Institute of Excellence sh.p.k, me administratore Znj. Bianca Fatbardha Duro - Spernbauer me NIPT K31610206F, zyra e regjistruar e se ciles ndodhet ne adresen: Rr Dibres, Kompleksi "Halili", Nd.64, H.6, Kati 9, Ap.37, Tirane, me pjesmarrje te ortakeve:

1. Bianca Fatbardha Duro - Spernbauer, me pjesemarrje 50%.
2. Hans Spernbauer, me pjesemarrje 50%.

Mbledhja mori ne shqyrtim rendin e dites se parashtruar nga administratori i shoqerise, Znj. Bianca Fatbardha Duro-Spernbauer :

1. Themelimi i kompanise AIEx Tech/Solution Shpk, ku kompania Austrian Institute of Excellence Shpk do te jete ortak Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 67,000 leke që përben 67% të kapitalit themeltar të shoqërisë AIEx Tech/Solution Shpk.

Bazuar ne Statutin e shoqerise merren vendimet sa vijon:

1. Miratohet themelimi i kompanise AIEx Tech/Solution Shpk, ku kompania Austrian Institute of Excellence Shpk do te jete ortak Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 67,000 leke që përben 67% të kapitalit themeltar të shoqërisë AIEx Tech/Solution Shpk.
2. Ngarkohet administratori i shoqerise Znj. Bianca Fatbardha Duro - Spernbauer te depozitoje vendimin e mesiperm prane organeve tatimore dhe ne QKB.

Vendimi i mesiperm merret nga Asambleja e Ortakeve, bazuar ne nenet perkates te Statutit te shoqerise, si dhe ne ligjin nr 9901 dt 14.04.2008 "per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

Per sa me siper u lexua ky vendim, i cili pasi lexohet, firmoset me vullnet te lire nga Ortaket.

Asambleja e Ortakeve

Znj. Bianca Fatbardha Duro-Spernbauer

Z. Hans Spernbauer

Austrian Institute of Excellence shpk.

AIE – Austrian Institute of Excellence
Head Office: Rruga e Dibrës, Kompleksi Halili 1017 Tiranë, Albania
Mobile: +355(0) 68 20 50 673
E-mail: office@aie.al Web: www.aie.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER SOKOL SH. MALAJ**

V2022050710001272110

**DATE 07/01/2022**
**NR REP 19**

# VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 07 Janar 2022 (dy mije e njëzet e dy), ditën e premte, para meje Noter SOKOL SH. MALAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANE, NR.2, LUIGJ GURAKUQI, u paraqitën personalisht:

## P A L Ë T:

**Z. HANS SPERNBAUER** i biri i Johan dhe Katharina lindur në Wartberg, Krems, Austri, më 04.02.1945, banues në Tiranë, Rr. Dibres, Kompeksi Halili, Nd.64, H.6, 1017,Tirana, Shqiperi, i identifikuar me Pasaporten Austriake me Nr. P 7286711, i cili asistohet në gjuhën shqipe nga bashkëshortja e tij Znj. BIANCA FATBARDHA DI DURO –SPERNBAUER.—

**Znj. BIANCA FATBARDHA DI DURO –SPERNBAUER** e bija e Bido dhe Ramnije lindur në Tiranë më 30.06.1963 banuese në Tiranë Rr "Dibrës", e paisur me Pasaportën Austriake U 3146229, aktualisht përdoruese e telefonit Nr 00355684026340.—

Deklaruesit e mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, "Vendim i Asamblesë së Ortakëve", bashkëlidhur e hartuar dhe nënshkruar prej palëve në prezencën time, -më datë 05.01.2022.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018"Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005: vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**
**SOKOL SH. MALAJ**